

# Adresimi i sfidave të raportit të Komisionit Evropian për Kosovën me Buxhetin e 2016

Mars 2016



## Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Komisionit Evropian (tutje Raporti) për Kosovën, përveç që bën një vlerësim gjithëpërfshirës të institucioneve kosovare në arritjen e objektivave në procesin e integrimi evropiane, po ashtu adreson edhe një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me kapacitetet buxhetore të institucioneve qendrore dhe lokale. Raporti për Kosovën, i fundit me radhë, u publikua më 11 nëntor 2015.<sup>1</sup> Pak ditë më vonë, Kuvendi i Kosovës miratoi në parim Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016<sup>2</sup>, pa ndonjë debat thelbësorë, duke anashkaluar këtu edhe të gjeturat e Raportit për vitin 2015.

Në këtë analizë, Instituti GAP ka përmbledhur disa prej të gjeturave kryesore të Raportit të vitit 2015 për Kosovën dhe ndarjet buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Kosovës 2016. Të gjeturat janë përmbledhur sipas fushave, për shembull zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, administrata publike, e kështu me radhë. Megjithëse ka pasur rritje të buxhetit për disa institucione që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, në përgjithësi të gjeturat tona tregojnë se ka nevojë për buxhet shtesë në mënyrë që Kosova të pranojë një Raport më të mirë për vitin 2016.

Problemet kryesore të adresuar sa i përket administratës publike janë mungesa e kapaciteteve për implementim të strategjisë për reformë publike, mungesa e profesionalizmit dhe shërbimeve elektronike. Në buxhetin e vitit 2016 nuk është paraparë ndonjë rritje thelbësorë për departamentet dhe projektet përkatëse në Ministrinë e Administratës Publike.

Edhe në sferën e zhvillimit ekonomikë, disa agjencioneve brenda ministrive nuk iu është rritur buxheti, megjithëse një gjë e tillë është kërkuar nga Raporti i vitit 2015. Kështu, Agjencia Kosovare për Standardizim dhe Agjencioni për Metrologji në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë do të kenë staf përkatësisht buxhet të njëjtë, ndërsa në Raport është rekomanduar rritje e kapaciteteve për këto dy agjenci. Edhe Agjencioni për Eficiencë të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomikë është cilësuar se ka mungesë të stafit për implementimin e detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga strategjitë për energji.

Mungesa e buxhetit është identifikuar edhe tek institucionet që merren me sundim të ligjit, trajnime profesionale, shëndetësi, mjedis, statistika etj.

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, Raporti 2015 për Kosovën, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>

<sup>2</sup> Kuvendi i Kosovës, Procesverbal i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës e mbajtur me 17 nëntor 2015, Burimi: <http://bit.ly/1U7kNQw>


## Përmbajtja

1.	Administratë Publike .....	4
2.	Zhvillim Ekonomik.....	6
2.1	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.....	6
2.2	Ministria e Zhvillimit Ekonomik .....	7
2.3	Ministria e Infrastrukturës.....	8
2.4	Buxheti i Institucioneve të Pavarura.....	9
3.	Punësimi dhe Çështjet Sociale.....	9
4.	Sundimi i Ligjit .....	11
4.1	Korrupsioni .....	13
4.2	Lufta kundër krimit të organizuar.....	13
5.	Bujqësia dhe Mjedisi.....	14
5.1	Bujqësia .....	14
5.2	Mjedisi .....	15
6.	Shëndetësi .....	16
7.	Media dhe Statistika .....	17
7.1	Media.....	17
7.2	Statistika .....	17
8.	Përfundime dhe rekomandime .....	19

# 1. Administratë Publike

Një nga kritikët kryesorë të adresuara në Raportin e 2015 lidhur me administratën publike, është mungesa e stafit të nevojshëm për implementimin dhe monitorimin e Strategjisë për Reformë në Administratën Publike. Si pasojë e burimeve shumë të kufizuara njerëzore, MAP ka pengesa në aplikimin e legjislacionit dhe parimeve në administratë publike.<sup>3</sup> Megjithë këto të gjetura të Raportit, buxheti i MAP-it për vitin 2016 nuk planifikon rritje të stafit për Departamentin për Menaxhimin e Reformës në Administratë Publike.


**Figura 1.** Numri i të punësuarve në MAP sipas departamenteve



Sipas Raportit të 2015, përveç mungesës së stafit ka edhe mungesë të profesionalizmit në administratë publike, dhe kjo si pasojë e ndërhyrjes politike dhe mungesës së trajnimeve. Mungesa e trajnimeve profesionale vjen si pasojë e mungesës së mjeteve financiare dhe objektit të përshtatshëm për Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Në buxhetin e vitit 2016, është planifikuar një rritje rreth 28 mijë euro (15%) në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe shërbimeve komunale për IKAP, por numri i të punësuarve ka mbetur i njëjtë. Ndërsa për ndërtimin e objektit të IKAP janë ndarë rreth 100 mijë euro, të bartura nga viti i kaluar.

<sup>3</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 12

Figura 2 Buxheti i MAP sipas departamenteve



Problem tjetër i adresuar në Raportin e 2015, është mungesa e shërbimeve elektronike (e-shërbimeve) në administratë publike për shkak të mungesës së kornizës ndërvepruese. Gjithashtu mungon edhe qasja e barabartë në shërbimet e personave me aftësi të kufizuara. Në buxhetin e vitit 2016, numri i stafit për Agjencionin e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të MAP planifikohet të rritet për pesë persona. Gjithashtu investimet kapitale do të rriten rreth 318 mijë euro (53%).

Probleme ka edhe në përdorimin e sistemit të teknologjisë informative sepse programi për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk është i azhurnuar. Në tabelën e investimeve kapitale të MAP nuk figuron ndonjë projekt kapital lidhur me programin për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Sa i përket strukturimit të përgjithshëm të administratës publike, sipas Raportit, mungesa e një kornize legjislative ka bërë që të krijohen një numër i madh i institucioneve të agjencive qeveritare me përgjegjësi të ndërthurura. Gjithashtu ka një numër të madh të institucioneve të pavarura të cilat drejtpërdrejt raportojnë në Kuvend, përderisa Kuvendi nuk ka kapacitete mbikëqyrëse.<sup>4</sup> Në një analizë tonën të më hershme patëm konstatuar se nga ristrukturimi i ministrive do të mund të kurseheshin rreth 3.6 milionë euro në vit nga shpenzimet e kabineteve.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 11

<sup>5</sup> Instituti GAP, Ristrukturimi i Qeverisë, korrik 2014, Burimi: <http://bit.ly/1vjlfxo>

## 2. Zhvillim Ekonomik

### 2.1 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Sa i përket shërbimeve të ofruara nga MTI-ja, Raportika kritikuar procesin e regjistrimit të biznesit. Edhe regjistrimi i bizneseve online edhe procedura e mbylljes së biznesit thuhet se kanë nevojë për përmirësime<sup>6</sup>. Sipas buxhetit 2016, regjistrimi i bizneseve do të marrë rreth 37 mijë euro më shumë se vitin e kaluar, por që kryesisht do të shkojnë në rritje të pagave dhe mëditjeve<sup>7</sup>.

Agjencia Kosovare për Standardizim, që operon brenda MTI-së, është vlerësuar si jo e konsoliduar. Për më tepër, Raportisugjeron zgjerim të ofrimit të produkteve online.<sup>8</sup> Mirëpo, buxheti për vitin 2016 parasheh vetëm një ngritje modeste, dhe atë kryesisht për mallra dhe shërbime<sup>9</sup>.

Rekomandime ka pasur edhe për rritjen e investimeve në pajisje për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të MTI-së.<sup>10</sup> Mirëpo, buxheti i vitit 2016 për këtë agjenci pothuajse nuk ka ndryshuar fare.

Raporti po ashtu përmend dy ligje për naftën që akoma nuk janë futur në fuqi. Në bazë të Programit Legjislativë të Qeverisë së Kosovës për vitin 2015, është planifikuar të miratohet Projektligji për Rezervat e Obligueshme të Naftës dhe Projektligji për Tregun e dhe Produkteve të Naftës në Kosovë<sup>11</sup>. Sipas vlerësimit të ndikimit buxhetor, projektligji për rezervat e obligueshme të naftës i paraparë të aprovohet në vitin 2015, nuk është përfshirë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018.

<sup>6</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 34

<sup>7</sup> Aneksi 2


<sup>8</sup> Ibid, faqe 39

<sup>9</sup> Aneksi 2

<sup>10</sup> Ibid

<sup>11</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Legjislativ për Vitin 2015, Burimi: <http://bit.ly/1QWeddc>

Figura 3 Buxheti për departamentet e MTI-së në 2015 dhe 2016



## 2.2 Ministria e Zhvillimit Ekonomik


Raporti 2015 ka kritikuar mungesën e Fondit për Eficiencë të Energjisë. Sipas këtij raporti, Agjencia për Eficiencë të Energjisë që funksionon në kuadër të kësaj ministrie, nuk ka staf të mjaftueshëm për të vlerësuar, monitoruar, dhe verifikuar progresin ndaj objektivave të caktuara për eficiencë<sup>12</sup>. Numri i lejuar i punëtorëve të kësaj agjencie ka mbetur i pandryshuar edhe këtë vit, mirëpo buxheti i është dyfishuar<sup>13</sup>. Agjencia duhet të ketë nëntë të punësuar ndërsa për momentin ka të punësuar vetëm katër persona.<sup>14</sup>

<sup>12</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 51

<sup>13</sup> Aneksi 3

<sup>14</sup> Agjencia për Eficiencë të Energjisë, Intervistë me email, 24.03.2016


Figura 4 Buxheti për departamentet e MZHE-së në 2015 dhe 2016



### 2.3 Ministria e Infrastrukturës

Në Ministrinë e Infrastrukturës, 100% e projekteve kapitale janë investime në infrastrukturë rrugore. Me gjithë buxhetin e ndarë për infrastrukturë rrugore, sipas Raportit 2015 buxheti i ndarë për mirëmbajtjen e autostradave është i pamjaftueshëm.<sup>15</sup> Në kuadër të MI-së nuk ka një linjë buxhetorë të ndarë për mirëmbajtje të autostradave, mirëpo buxheti për mirëmbajtje të rrugëve ka rënie prej 1%.

Figura 5 Ndarja e buxhetit të MI-së për infrastrukturë rrugore



<sup>15</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 47




## 2.4 Buxheti i Institucioneve të Pavarura

Raporti ka adresuar çështjen e politizimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), mungesën e stafit dhe buxhetit si njëri nga shqetësimet kryesore.<sup>16</sup> Megjithatë buxheti i ndarë për ZRRE-në planifikohet të rritet, stafi ka mbetur i njëjtë si në vitin paraprak.

Raporti po ashtu ka rekomanduar që të rritet stafi, pajisjet dhe trajnimet në Autoritetin Kosovor i Konkurrencës (AKK). Për këtë vit, AKK-së i është rritur buxheti për rreth 65 mijë euro, mirëpo numri i lejuar i punëtorëve ka mbetur i njëjtë.<sup>17</sup> Në mungesë të objektit, AKK ende nuk ka mundur që t'i plotësojë vendet e lira të punës.<sup>18</sup>

Mungesa e kapaciteteve është identifikuar edhe tek Autoriteti i Rregullatorit të Hekurudhave (ARH). Sipas buxhetit 2016, ARH-së i është rritur buxheti, mirëpo numri i punëtorëve do të mbetet i njëjtë.

Figura 6 Trendet e buxhetit për agjencionet dhe institucionet e pavarura



## 3. Punësimi dhe Çështjet Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) si bartëse e buxhetit për skema sociale dhe pensione, është ministria me buxhetin më të madh në vitin 2016. Krahasuar me vitin e kaluar buxheti i kësaj


<sup>16</sup> Ibid, faqe 34

<sup>17</sup> Ibid, faqe 41

<sup>18</sup> Arsim Tërnavë, Autoriteti Kosovor i Konkurrencës, Përgjigje me email 14 mars 2016

ministrie është rritur për 52 milionë euro (17%). Ashtu siç është paraqitur në Figurën 7, shumica e buxhetit (88%) të kësaj ministrie do të shkojë në pensione. Buxheti për mirëqenie sociale zë 10% të buxhetit ndërsa çështjet e punësimit zënë vetëm 2% të buxhetit të kësaj ministrie.

Figura 7 Ndarja e buxhetit të MPMS-së



Buxheti për Departamentin e Trajnimit Profesional ka mbetur i njëjtë me vitin e kaluar, ndërkohë që trajnimi profesional konsiderohet një ndër aspektet kritike për zhvillim të punësimit në PKRE. Gjithashtu, sipas Raportit të 2015, financimi për trajnime profesionale mbetet i pamjaftueshëm.<sup>19</sup> Aty është përmendur si problem edhe mungesa e buxhetit për të implementuar Strategjinë për Punësim 2014-2020.<sup>20</sup>

Sa i përket buxhetit për çështje të punësimit në kuadër të MPMS-së, është planifikuar një rritje e stafit prej pesë personash (gjithsejtë 70) tek Autoriteti i Inspektionit të Punës. Ky mund të konsiderohet një hap pozitiv duke marrë parasysh se implementimi i Ligjit të Punës është konsideruar shumë i dobët në Raportin e vitit 2014 dhe 2015 për Kosovën.<sup>21</sup> Shqetësim tjetër që përmendet është edhe angazhimi i fëmijëve nga komuniteti Romë, Egjiptian dhe Ashkali në punë të hershme dhe mungesa e masave aktive për punësim për këtë komunitet.<sup>22</sup>

Edhe "Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive", e nënshkruar në mes të sindikatave dhe Qeverisë së Kosovës në vitin 2014, thuhet se nuk është duke u implementuar ende për shkak të mungesës së buxhetit.

<sup>19</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 36


<sup>20</sup> Ibid, faqe 44

<sup>21</sup> Ibid, faqe 44

<sup>22</sup> Ibid, faqe 26

Nga Figura tetë shohim se rritja më e madhe e buxhetit prej 50 milionë euro (19%) ka ndodhur tek pensionet. Kjo kryesisht për shkak të implementimit të Ligjit për Veteranët e Luftës i cili ka kosto 25 milionë euro dhe rritjes së buxhetit për pensionistët kontributdhënës prej 23 milionë euro. Tek pensionet, vetëm kategoria e pensioneve për invalidët e luftës ka pësuar rënie prej 2.6 milionë euro (6%).<sup>23</sup> Kur jemi tek pensionet, Raporti i 2015 ka adresuar si shqetësim largimin e pabazuar të 1,000 personave nga komuniteti i të shurdhërve nga lista e pensioneve.<sup>24</sup> Aty përmendet edhe mungesa e ndarjes së fondeve për komuna sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale.<sup>25</sup>

**Figura 8** Trendi i ndarjeve buxhetore sipas departamenteve- MPMS



## 4. Sundimi i Ligjit

Sipas Raportit 2015, në përgjithësi institucionet të cilat merren me sundimin e ligjit kanë mungesë të vazhdueshme të buxhetit. Numri i gjyqtarëve të cilët merren me krime të rënda mbetet i ulët dhe gjithashtu ka mungesë të stafit në Këshillin Gjyqësor të Kosovë (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) sa i përket monitorimit të implementimit të vendimeve.

Megjithëse ka pasur një përmirësim të numrit të rasteve të zgjidhura brenda vitit, nga 74% në 84%, mungesa e fondeve ka rezultuar me një

<sup>23</sup> Shih Aneksin 4 sa i përket detajeve të buxhetit për departamentet e MPMS-së

<sup>24</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 24

<sup>25</sup> Ibid, faqe 45

administratë të ngadalshme. Në fillim të vitit 2015, Prokuroria e Shtetit kishte rreth 121 mijë raste të pazgjidhura, ndërsa KGJK rreth 92 mijë. Rritja e stafit dhe buxhetit është një nga rekomandimet kryesore për ta përmirësuar këtë gjendje.<sup>26</sup>

Buxheti i ndarë për Prokurorinë e Shtetit për vitin 2016 është rreth 871 mijë euro më i lartë se vitin e kaluar, ndërsa për KGJK-në rreth 1.2 milionë euro. Nga tabela e mëposhtme shohim se planifikohet një rritje e stafit për KGJK-në prej 41 punonjësish ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë do të punësojë 36 prej tyre. Rritje të stafit prej 50 punonjësish do të ketë edhe në Prokurorinë e Shtetit (PSH). Megjithëse numri i lejuar i punëtorëve nga MF për këto dy institucione është rritur, kjo nuk garanton se do të rritet numri i të punësuarve real. Për shembull, përderisa në PSH dhe KGJK në vitin 2015 janë lejuar të punësohen 648 përkatësisht 2,118 persona, numri aktual i të punësuarve në tetor të 2015 ishte 569 përkatësisht 1,795.

**Tabela. 1** Numri i stafit në KGJK

	Të punësuar 2015	Të punësuar 2016	Dallimi
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	89	88	-1
Sekretariati i KGJK-së	278	265	-13
Njësia e Shqyrtimit të Performancës	7	7	0
Zyra e Prokurorit Disiplinor	20	20	0
Gjykata e Apelit	121	111	-10
Gjykata Themelore në Prishtinë	416	452	36
Gjykata Themelore në Prizren	219	225	6
Gjykata Themelore në Gjiilan	199	202	3
Gjykata Themelore në Ferizaj	163	168	5
Gjykata Themelore në Pejë	230	231	1
Gjykata Themelore në Gjakovë	159	160	1
Gjykata Themelore në Mitrovicë	217	230	13
<b>Total</b>	<b>2,118</b>	<b>2,159</b>	<b>41</b>

Sipas Raportit 2015, përveç mungesës së stafit, në gjykata mungon sistemi elektronik i monitorimit dhe në përgjithësi përdorimi i teknologjisë informative mbetet i ulët.<sup>27</sup> Në buxhetin 2016, tek buxheti i KGJK-së janë ndarë rreth 100 mijë euro vazhdim nga viti i kaluar për pajisje të audio-incizimit. Ndërkaq, në buxhetin e Prokurorit të Shtetit janë ndarë rreth 70 mijë euro për menaxhimin elektronik të lëndëve. Megjithatë në buxhetin e këtij institucioni figuron një projekt për blerjen e fotokopjeve, por për të cilin nuk është ndarë asnjë euro.

<sup>26</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 14

<sup>27</sup> Ibid, faqe 15

Tabela 2 Projektet Kapitale të KGJK-së

Projekti	Buxheti 2016
Riparimet emergjente rryma, uji, kanalizimi ne objektet e Gjykatave	150,000
Pajisje te sigurisë dhe videovegimit	100,000
Projekti i audio incizimit për gjykata	100,000
Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit Gjykatës Themelore ne Ferizaj	791,000

#### 4.1 Korrupsioni

Sipas Raportit 2015, megjithëse korniza ligjore sa i përket financimit të partive është përmirësuar, ka mungesë sa i përket implementimit të rregullave për financim, mungesës së monitorimit dhe trupave rregulluese. Për shkak të ndikimit politik dhe kapaciteteve të kufizuara, në raste të rralla janë kryer hetime për korrupsion në nivele të larta. Mungesa e ekspertizës vendore për të trajtuar hetime komplekse financiare dhe konfiskim të aseteve kriminale ka rezultuar me numër të vogël të rasteve të suksesshme të hetimit.

*Task forca* antikorrupsion e cila ka 30 hetues, tetë prokurorë dhe pesë ekspertë të orientuar në korrupsion të nivelit të lartë dhe krime financiare duhet të forcohet tutje që të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet agjencive.<sup>28</sup>

#### 4.2 Lufta kundër krimit të organizuar

Në përgjithësi Kosova është në fazë të hershme sa i përket luftimit të krimit të organizuar. Numri i të dënuarve dhe hetimeve financiare, hetimi i rasteve kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe konfiskimit të drogave mbetet i ulët.<sup>29</sup>


Prokurorët vendorë janë të përkushtuar mirëpo kanë mungesë të ekspertizës, veçanërisht sa i përket hetimeve të krimeve të luftës. Gjithsejtë 12 nga 15 pozitat për prokurorë lokal janë plotësuar në Zyrën e Prokurorëve Special, mirëpo kjo zyre nuk i ka burimet njerëzore të mjaftueshme për të përballuar numrin e lëndëve që do të barten nga EULEX-i.<sup>30</sup> Sipas buxhetit 2016, numri i stafit në prokurori speciale do të mbetet i njëjtë sikurse në vitin 2015 (gjithsejtë 54).

<sup>28</sup> Ibid

<sup>29</sup> Ibid, faqe 19

<sup>30</sup> Ibid, faqe 20

Figura 10. Të punësuar në Prokurorinë e Shtetit



Gjithashtu Policia e Kosovës ka mungesë të hetuesve me etni Serbe, inteligjencë për hetime kriminale të kufizuar, mungesë të pajisjeve bazë siç janë kompjuterët dhe veturat. Në ligjin e buxhetit 2016 janë ndarë 1.3 milionë euro për automjete të transportit dhe 300 mijë euro për pajisje të teknologjisë informative.

Problem tjetër sa i përket çështjeve të krimit të organizuar, janë burimet njerëzore dhe menaxheriale për patrullime "intelegjente" të policisë të cilat kanë nevojë të përmirësohen. Gjithashtu sa i përket Policisë së Kosovës, sistemi i ri i teknologjisë informative në polici duhet të përmirësohet në të gjitha nivelet, në mënyrë që të përmirësohet analiza e rrezikut dhe operacionet proaktive. Krahasuar me vitin e kaluar, investime kapitale në policinë e Kosovës kanë rënë për rreth një milionë euro..

## 5. Bujqësia dhe Mjedisi

### 5.1 Bujqësia

Raporti për vitin 2014 dhe ai për vitin 2015 identifikojnë prerjen e drunjve dhe menaxhimin e pyjeve si një ndër problemet më të rëndësishme të kësaj ministrie. Vazhdimi i trendit të prerjes së drunjve në mënyrë ilegale është i paqëndrueshme dhe duhet të adresohet në mënyrë urgjente nga Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK)<sup>31</sup>. Në vitin 2016 buxheti i APK-së do të rritet për rreth 372 mijë euro (19%). Po ashtu, ngritje buxhetore do të ketë edhe Departamenti

<sup>31</sup> Raporti i Progresit 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 47

i Pylltarisë (DP) për rreth 2 mijë euro (2%), i cili në total do të jetë 96 mijë euro. Krahas këtyre ngritjeve buxhetore, në vitin 2016 do të rritet edhe numri i të punësuarve në APK për 20 persona.

**Tabela 3. Trendi i buxheteve të institucioneve të MBPZhR**

	2014	2015	2016
Agjencia Pyjore e Kosovës	2,341,683	1,993,209	2,365,642
Departamenti i Pylltarisë	115,793	93,990	95,946
Instituti Bujqësor i Kosovës	933,065	571,961	584,460
Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	371,871	347,518	1,333,726
Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtare	16,346,501	30,754,773	25,748,560
Shërbimet e Administratës	5,405,269	2,396,580	3,908,014
Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore	606,227	589,126	601,080
Departamenti i Vreshtarisë	84,953	96,905	403,895
Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural	109,050	18,094,482	21,557,635
Departamenti i Shërbimeve	780,967	655,045	567,845
Departamenti ligjor	48,587	37,040	39,980
Njësia për të drejtat e njeriut	26,521	26,732	29,489

Raporti për vitin 2014 dhe ai i vitit 2015 shoh si problematikë mungesën e stafit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për të kontrolluar dhe monitoruar ndarjen e subvencioneve për bujqësi. Për zgjidhjen e këtij problemi është rekomanduar formimi i një grupi për auditim të brendshëm.

## 5.2 Mjedisi

Në Raportin për vitin 2014 dhe atë të 2015 paraqitet si problem monitorimi i kualitetit të ajrit dhe ujërave. Raportet theksojnë se edhe pse pajisjet teknike të monitorimit ekzistojnë, ato nuk janë të kompletuara. Buxheti për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e tyre, nuk është i mjaftueshëm.<sup>32</sup> Po ashtu, për shkak të mungesës së buxhetit të dhënat e publikuara nga Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) për kualitetin e ajrit, nuk janë të qasshme në kohë reale<sup>33</sup>.

<sup>32</sup> Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Përgjigje me email, 10 mars 2016

<sup>33</sup> Raporti i Progresit 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 48

Për më tepër, Raporti thekson se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ketë një plan për menaxhimin e mbeturinave dhe të investojë më tepër në këtë aspekt. Mirëpo, në buxhetin e planifikuar për vitin 2016, janë vetëm një numër i vogël i projekteve të cilat kanë për qëllim menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu, ligji për menaxhimin e mbeturinave nuk precizon qartë çështjen e riciklimit, dhe ky mos precizim kufizon përfshirjen e bizneseve private që do të ishin të interesuar të investonin në riciklimin e mbeturinave<sup>34</sup>.

Një tjetër pengesë në dy raportet e lartpërmendura shihet zbatimi i ligjit të ri për Planifikim Hapësinor. Ky ligj nuk gjen zbatim të mjaftueshëm për shkak të mos koordinimit të akterëve që merren me lejet e ndërtimit dhe zbatimit të sanksioneve për ndërtime dhe shfrytëzime të tokës në mënyrë të paligjshme. Raporti po ashtu thekson që ligji për prodhime organike ka një zbatimin mjaft të dobët dhe se themelimi i një komisioni mbikëqyrës për këtë ligj ende nuk është formuar<sup>35</sup>.

## 6. Shëndetësi

Edhe këtë vit Fondi i Sigurimit Shëndetësorë si një ndër projektet kryesorë sa i përket sektorit të shëndetësisë nuk është përfshirë në buxhet. Ligji për Sigurime Shëndetësore është miratuar në vitin 2014 dhe për implementimin e tij nevojitet krijimi i një fondi prej 18 milionë euro nga buxheti i Kosovës.<sup>36</sup> Sipas Ministrisë së Shëndetësisë ky fond nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2016 për arsye të prioriteteve tjera buxhetore.<sup>37</sup>

Përveç mungesës së sigurimeve shëndetësore, sipas Raportit të 2015 shpenzimet publike në shëndetësi janë ndër më të ulëtat në rajon. Megjithë këtë konstatim, buxheti i ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Klinik Spitalorë për vitin 2016 është rritur për vetëm 1%.

Si pasojë, mungesa e buxhetit pengon realizimin e nevojave bazike për shëndetin e nënës dhe fëmijëve dhe shëndetit publik në përgjithësi.<sup>38</sup> Raporti i 2015, gjithashtu kritikon sektorin e shëndetësisë për mungesën e shërbimeve të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara.<sup>39</sup> Probleme tjera të adresuara në këtë

<sup>34</sup> Ibid. Fq. 48.

<sup>35</sup> Ibid, faqe. 47

<sup>36</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, Burimi: <http://bit.ly/1MhAePq>

<sup>37</sup> Telegrafi.com, Ministria kritikohet për tërheqjen nga Ligji për Sigurime Shëndetësore, Burimi: <http://bit.ly/1HTf1Y5>

<sup>38</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 45

<sup>39</sup> Ibid, faqe 20




raport janë: a) mungesa e zbatimit të ligjit për duhanin; b) mungesa e infrastrukturës dhe raportimit për sëmundjet ngjitëse; c) parandalimi i përdorimit të drogave; d) ekzaminimi i sëmundjes së kancerit etj.

## 7. Media dhe Statistika

### 7.1 Media

Sa i përket Komisionit të Pavarur të Medieve (KPM), problematike është cilësuar mungesa e buxhetit për të plotësuar obligimet financiare në vitin 2014 dhe realizimin e investimeve kapitale. Përkundër nevojës për rritje të buxhetit të adresuar nga Raporti 2015, siç shihet nga Figura 11, buxheti do të pësojë ulje prej rreth 219 mijë euro (-21%) ndërsa numri i stafit do të mbetet i njëjtë (gjithsejtë 31).

Figura 11. Buxheti për KPM




### 7.2 Statistika

Në përgjithësi sektori i statistikave është vlerësuar në fazë shumë të hershme nga Raporti 2015.<sup>40</sup> Një ndër shkaktarët e kësaj është mungesa e stafit administrativ dhe mjeteve financiare në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Përveç mungesës së stafit, ka mungesë të trajnimeve për stafin e ri sa i përket metodave të mbledhjes dhe kualitetit të statistikave.

<sup>40</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 55

Figura 12. Buxheti i ASK-së



Buxheti i ndarë për ASK-në në vitin 2016 planifikohet të rritet për rreth 45 mijë euro (4%), kjo ngase numri i të punësuarve në këtë agjencion pritet të rritet për 10 persona. Mirëpo për shkak se këtë persona do të punësohen në kuadër të integritit të strukturave të ashtuquajtura "Mbrojtja Civile" nuk kanë përgatitje profesionale.<sup>41</sup>

<sup>41</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Intervistë me email, 16 mars 2016

## 8. Përfundime dhe rekomandime

Raporti i Komisionit Evropian është dokument kyç në procesin e integritimeve evropiane të Kosovës. Adresimi i të gjeturave nga ky raport përveç tjerash ka edhe një kosto buxhetore. Në mënyrë që Kosova të pranojë një raport më të mirë të progresit 2016 ka nevojë për rritje të buxheti dhe plotësim të stafit për një sërë institucionesh. Në procesin e hartimit të buxhetit nevojitet që Ministria e Integritimeve Evropiane, Komisionin Parlamentar për Integritime Evropiane dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa të luaj rolin e koordinuesit dhe monitoruesit të ndarjeve buxhetore krahas të gjeturave të raportit të progresit, ndërsa Ministria e Financave të krijojë sa më shumë hapësirë buxhetore.

Duke marrë parasysh këto të gjetura, Instituti GAP rekomandon rritje të stafit/ buxhetit për këto ministri, agjencione apo institucione të pavarura:

- Departamentit për Menaxhimin e Reformës në Administratë Publike (MAP);
- Institutit të Kosovës për Administratë Publike (MAP);
- Regjistrimin e Bizneseve, Agjencinë e Metrologjisë, Agjencinë Kosovare për Standardizim (MTI);
- Agjencinë për Eficiencë të Energjisë (MZHE);
- Mirëmbajtja e rrugëve (MI);
- Rregullatorin për Energji Elektrike (ZRRE);
- Autoritetin Kosovar të Konkurrencës;
- Departamentin për Trajnime Profesionale (MPMS);
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Klinik Spitalorë të Kosovës;
- Institucionet/ departamentet që kryejnë hetime lidhur me krimin e organizuar siç janë: Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit;
- Këshillin e Pavarur për Media;
- Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Të rriten investimet në teknologji informative rrjedhimisht shërbimet elektronike në administratë publike;
- Të ndahet buxhet për menaxhimin e shërbimeve sociale në komuna; dhe
- Të rritet stafi për mbikëqyrje në Kuvendin e Kosovës.



Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

#### Instituti GAP mbështetet nga:



#### Ky projekt është mbështetur nga:

